



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. Prot.

Tiranë, më .2021

VENDIM
Nr. 533, datë 17.11.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES , ME
QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares l me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares , për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E
VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER
VLERËSIMI**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

**1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES,
LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se "...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ajo përcakton natyrën e mosmarrëveshjes civile dhe analizon me shumë kujdes cilësimin juridik të veprës penale. Identifikon normën materiale të zbatueshme dhe shpjegon gjerësisht kuptimin e saj në raport me faktet e mosmarrëveshjes dhe kërkimet e palëve. Njeh dhe përdor parimet e përgjithshme të së drejtës (shih dokumentin 3 dhe dosjen 3), si dhe jurisprudencën e gjykatave më të larta (shih dokumentet 1, 2, 3)".

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit. Evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje dhe në mënyrë të integruar me provat e administruara gjatë gjykimit.

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes pothuajse në të gjitha vendimet e analizuara, vlen të theksohet se pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, familjar apo gjykim penal*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale*), rrethanat e fakteve parashtrohen në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese, menjëherë pas prezantimit të çështjes dhe arsyetimit lidhur me juridiksionin, kompetencën apo kërkesat procedurale të palëve, sikurse është rasti i pranimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale. Gjithashtu, gjyqtarja pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi përpara një mosmarrëveshje civile të lindur nga përgjegjësia jashtëkontraktore, mosmarrëveshje pronësie apo mosmarrëveshje tregtare etj.*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), si dhe llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale. Përcaktimi i saktë i natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe në funksion të saj, në të gjitha vendimet e analizuara (*si në çështje civile edhe në ato penale*) në pjesën përshkruese-arsyetuese gjyqtarja ka analizuar shkurtimisht juridiksionin dhe kompetencën e saj për shqyrtimin e çështjes. Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes, edhe ku nuk është identifikuar në mënyrë specifike, del qartë, referuar identifikimit të elementëve dhe kritereve ligjore të mosmarrëveshjes juridike.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu edhe me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural dhe material në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtarja identifikon ligjin e

zbatueshëm, citon në disa raste dispozita të ligjit material ose procedural, si dhe analizon përmbajtjen e tyre kur është vlerësuar e nevojshme, në mënyrë të integruar me faktin, ose në mënyrë të pavarur, para aplikimit mbi faktet e çështjes. Duke i referuar burimeve të vlerësimit në dy kategori: (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, sa i përket identifikimit të ligjit të zbatueshëm procedural dhe material, rezulton si më poshtë:

(i) Në vendimet civile (çështje me pavërtetësi dokumenti, kërkim sendi, pjesëtim pasurie, vërtetim fakti, shpërblim dëmi, zgjidhje martesë dhe autorizim për tjetërsim prone) gjuqtarja identifikon dhe referon drejtpërdrejt në pjesën hyrëse dhe në përmbajtje të arsytimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 35/3, 36/1, 41, 42, 45, 48/1, 51 dhe 388 të K.Pr.Civile lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor civil, si dhe kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes civile, familjare ose tregtare;
- nenin 35/3 të K.Pr.Civile, lidhur me përbërjen e trupit gjykues; nenin 388 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e interesit të ligjshëm në ngritjen e kërimit para gjykatës për vërtetimin e faktit;²³
- nenet 32/a të K.Pr.Civile lidhur me përcaktimin e natyrës së padisë, si padi për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose një interesi të ligjshëm që është shkelur;²⁴
- nenet 32/c të K.Pr.Civile lidhur me përcaktimin e natyrës së padisë si padi njohje; nenet 253 dhe 254 të K.Pr.Civile lidhur me cilësinë e provës dhe fuqinë provuese të akteve zyrtare;²⁵
- nenet 370 dhe 373/1 të K.Pr.Civile lidhur me fazat e gjykimit të padisë për pjesëtimin e sendeve në bashkëpronësi;²⁶
- nenin 106 të K.Pr.Civile në lidhje me përcaktimin e detyrimit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore në raport me disponimin për padinë.²⁷

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në të gjitha çështjet civile, referuar objektit të mosmarrëveshjes, gjuqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm:

- nenet 132, 2, 155 dhe 146 të Kodit të Familjes lidhur me zgjidhjen e martesës dhe pasojat e saj në raport me bashkëshortët, si dhe në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për fëmijën e mitur;²⁸

²³ Vendimi nr. 80/22-2016-168, datë 01.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

²⁴ Vendimi nr. 113/22-2016-244, datë 19.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

²⁵ Vendimi nr. 142/22-2015-240, datë 08.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

²⁶ Vendimi nr. 11, datë 10.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

²⁷ Vendimi nr. 11/22-2016-24, datë 26.01.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

²⁸ Vendimi nr. 91/22-2016-192, datë 15.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

- nenet 199, 200/ç, 207 dhe 228 të K.Civil në lidhje me të drejtën që ka secili nga bashkëpronarët për të kërkuar pjesëtimin e sendit, si dhe lidhur me bashkëpronësinë midis anëtarëve të familjes bujqësore;²⁹
- nenet 608 dhe 609 lidhur me përgjegjësinë civile për shkaktimin e dëmit;³⁰
- nenet 157, 160 dhe 167 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në lidhje me të drejtën që ka asambleja e përgjithshme të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të administrimit; në lidhje me shpërblimin që përfitojnë anëtarët e këshillit të administrimit, si dhe në lidhje me të drejtat e detyrimit e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët;³¹
- nenin 234 të Kodit të Familjes në lidhje me kushtet që duhen të plotësohen në mënyrë kumulative për lëshimin e autorizimit për tjetërsimin e pasurisë.³²

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon, citon dhe në disa raste analizon ligjin e zbatueshëm, procedural dhe material, si pjesë të integruar të arsytimit të vendimit, për të vlerësuar rrethanat procedurale të çështjes, apo për të analizuar elementët e figurës së veprës penale, përcaktimin dhe individualizimin e dënimit dhe aplikimin e dënimeve alternative, disponimin për provat materiale, etj.

Sa i përket ligjit procedural penal, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm:

- nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar dhe nenin 406 të K.Pr.Penale lidhur me uljen e masës së dënimit;³³
- nenet 74/1 dhe 76/1 sa i përket vlerësimit të çështjes së juridiksionit dhe kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës për gjykimin e çështjeve penale;
- nenet 13/3 të K.Pr.Penale lidhur me përbërjen e trupit gjykues për gjykimin e çështjes;
- nenet 190 dhe 393 të K.Pr.Penale sa i përket disponimit për provat materiale dhe shpenzimet gjyqësore.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në vendimet penale të analizuara, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal.

- Konkretisht, gjyqtarja identifikon nenin 297 të K.Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale të "Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror",³⁴ nenin 130/a të K.Penal

²⁹ Vendimi nr. 11, datë 10.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

³⁰ Vendimi nr. 69/22-2016-143, datë 02.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

³¹ Vendimi nr. 11/22-2016-24, datë 26.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

³² Vendimi nr. 5, datë 14.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

³³ Vendimi nr. 58/22-2015-441, datë 23.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

³⁴ Vendimi nr. 34/22-2015-261, datë 24.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

në lidhje me akuzën e “ Dhunës në familje”,³⁵ nenin 278/3 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”,³⁶ nenin 199/a/2 të K.Penal në lidhje me akuzën “Ndërtimi i paligjshëm”,³⁷ nenin 89 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Plagosjes së lehtë me dashje”,³⁸ nenin 134/2 në lidhje me akuzën e” Vjedhjes së kryer në bashkëpunim”, nenin 134/3 të K.Penal në lidhje me akuzën e “ Vjedhjes me pasoja të rënda”.³⁹

- Në çdo rast referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, lidhur me përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, individualizimin e tij, si dhe aplikimin e dënimeve alternative (*nenet 47, 49, 50, 59 të K.Penal*).

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet e analizuara nuk rezultojnë të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

Vendimi nr. 26, datë 21.04.2014, vendimi nr. 41/22-2015-334, datë 06.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

Vendimi nr. 26, datë 21.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

Vendimi nr. 27, datë 22.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

Vendimi nr. 14, datë 10.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

Vendimi nr. 58/22-2015-441, datë 23.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ajo përcakton natyrën e mosmarrëveshjes civile dhe analizon më shumë kujdes cilësimin juridik të veprës penale. Identifikon normën material të zbatueshme dhe shpjegon gjerësisht kuptimin e saj në raport me faktet e mosmarrëveshjes dhe kërkimet e palëve. Njeh dhe përdor parimet e përgjithshme të së drejtës (shih dokumentin 3 dhe dosjen 3), si dhe jurisprudencën e gjykatave më të larta (shih dokumentet 1, 2, 3)”*.

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen ose referohen, duke u shoqëruar në disa raste me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile ose të çështjes penale objekt shqyrtimi.

- Në drejtim të interpretimit të ligjit material të zbatueshëm:

Sa i përket interpretimit të ligjit material të zbatueshëm, sipas natyrës së vendimit, rezultojnë se gjyqtarja ka interpretuar dispozitat respektive në mënyrë të pavarur vetëm në disa raste, kryesisht në vendimet penale, ndërsa në rastet e tjera, pas citimit të dispozitave, vijon me aplikimin e tyre mbi faktet e çështjes në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa i shoqëruar ato me interpretim të kuptimit dhe qëllimit të tyre, kushtëzuar kjo edhe nga mungesa e kompleksitetit të çështjeve referuar natyrës së mosmarrëveshjeve civile apo çështjeve penale të trajtuara.

Në vendimet civile burim vlerësimi. Interpretimi i normës juridike bëhet vetëm në disa raste, duke identifikuar qëllimin e normës, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë që të gjejë zbatim dispozita, në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore evidentohet se gjyqtarja interpreton dispozita të ligjit material:

- gjyqtarja interpreton nenin 234 të Kodit të Familjes, për të përcaktuar se cilët janë kushtet që duhen të plotësohen që të lëshohet nga gjykata autorizimi për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme të fëmijës së mitur;⁴⁰
- gjyqtarja interpreton në mënyrë literale nenet 608 dhe 609 të Kodit të Civil, në drejtim të përcaktimit të kushteve që duhen plotësuar në mënyrë kumulative për të lindur përgjegjësia civile për shpërblimin e dëmit, para aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes, në shërbim të konkluzionit të arritur lidhur me zbatimin e tyre në zgjidhjen e çështjes.⁴¹

Në vendimet e tjera civile të analizuara, dispozitat janë cituar dhe zbatuar drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, pa u shoqëruar me një interpretim të pavarur të tyre, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e thjeshtë e objektit të padive të trajtuara.

Në vendimet penale të analizuara, kryesisht në vendimet e themelit, gjyqtarja citon nenet e pjesës së posaçme të Kodit Penal dhe i interpreton ato në drejtim të vlerësimit lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal, si dhe analizës së elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën procedohet i pandehuri. Në këto vendime interpretohen gjithashtu dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, sa i përket përcaktimit të qëllimit të dënimit penal, kushteve dhe kritereve ligjore të individualizimit të dënimit, si dhe aplikimit të masave alternative të dënimit me burgim. Interpretimi i dispozitave të ligjit penal material, në disa raste, duke iu referuar natyrë së dispozitës dhe elementëve të saj, pasurohet me qëndrime të praktikës gjyqësore. Konkretisht, në vendimet penale të themelit, interpretohen në aspektin teorik duke u dhënë kuptimi dhe qëllimi i dispozitës, nenet 134/2, 130/a, 199/a/2, 278/3, 297 dhe 89 të Kodit Penal, të cilët analizohen në mënyrë të plotë në të katër elementët e figurës së veprës penale (*objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive*), para aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes.

Në vendimet penale të themelit gjyqtarja ka interpretuar edhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në drejtim të përcaktimit të qëllimit të dënimit penal, kushteve dhe kritereve të individualizimit të dënimit, sipas parashikimeve të nenit 47 të Kodit Penal, si dhe kushteve të aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit, sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal, kushte të cilat referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet e çështjes, duke u shoqëruar me një analizë të shkurtër të tyre, pa qëndruar në interpretimin e veçantë dhe abstrakt të tyre.⁴²

- ***Në drejtim të interpretimit të ligjit procedural:***

Nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi interpretimit të disa dispozitave procedurale që zbatohen mbi rrethanat procedurale, duke

⁴⁰ Vendimi nr. 5, datë 14.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

⁴¹ Vendimi nr. 69/22-2016-143, datë 02.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

⁴² Vendimi nr. 41/22-2015-334, datë 06.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

u ndalur vetëm në disa raste në interpretimin teorik të tyre dhe në shumicën e rasteve në aplikimin e drejtpërdrejtë të tyre mbi faktet e çështjes.

Në vendimet penale të analizuar, sa i përket ligjit procedural, rezultojnë interpretimi i nenit 404 të K.Pr.Penale në lidhje me kushtet procedurale të pranueshmërisë së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, duke u shoqëruar ky interpretim me referimin e praktikës gjyqësore, konkretisht, vendimit nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.⁴³

Në vendimet civile të analizuar, sa i përket ligjit procedural, normat referohen dhe citoohen, duke u aplikuar mbi aspektet procedurale në funksion të të cilave ato referohen (*vlerën provuese të akteve zyrtare, lidhur me fazat e gjykimit të padisë për pjesëtimin e sendeve në bashkëpronësi*), pa u shoqëruar me interpretim të pavarur të kuptimit të tyre, përveç interpretimit të nenit 32/c në lidhje me përcaktimin e natyrës së kërkesëpadisë si padi njohje dhe përcaktimin e interesit të ligjshëm të paditësit për të ngritur padinë,⁴⁴ si dhe interpretimit të nenit 388 të K.Pr.Civile në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, për vërtetimin e lindjes, ndryshimit apo shuarjes së një të drejte personale apo pasurore.⁴⁵ Interpretimi i kufizuar i normave procedurale në vendimet civile të analizuar në rastin konkret duket se është kushtëzuar edhe nga objekti i mosmarrëveshjeve të trajtuara, të cilat nuk rezultojnë të kenë elementë apo aspekte procedurale të cilat janë vënë në diskutim, çka do të bënte të nevojshëm interpretimin e pavarur të dispozitave të caktuara procedurale.

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Nga tërësia e vendimeve të analizuar, rezultojnë se gjyqtarja në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në disa raste duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve, rezultojnë se gjyqtarja njih dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimi e ligjshmërisë – nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit në të cilat gjyqtarja, pavarësisht se nuk referon në mënyrë të shprehur këtë parim, analizojnë domosdoshmërinë e ekzistencës dhe provueshmërisë së të katër elementëve të figurës së veprës penale, si kusht për ekzistencën e saj dhe për pasojë, për përgjegjësinë penale të të pandehurit për faktin penal që i atribuohet.

⁴³ Vendimi nr.58/22-2015-441, datë 23.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

⁴⁴ Vendimi nr.142/22-2015-240, datë 08.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

⁴⁵ Vendimi nr.80/22-2016-168, datë 01.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

- Parimet e përgjithshme në caktimin dhe individualizimin e dënimit, *si parimi i barazisë para ligjit, parimi i drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe parimin e humanizmit*. Këto parime, pavarësisht se nuk citohen shprehimisht, rezultojnë të jenë zbatuar nga gjyqtarja në të gjitha vendimet penale të themelit, ku ajo interpreton paraprakisht qëllimin e dënimit penal dhe më pas vijon me përcaktimin dhe individualizimin e dënimit, duke iu referuar kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 47 të Kodit Penal, prezencën dhe ndikimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese;
 - Parimin *“in dubio pro reo”* (përtej çdo dyshimi të arsyeshëm) dhe parimi i prezumimit të pafajësisë;⁴⁶
 - *Parimin e procesit të rregullt ligjor*, aspekte të të cilit rezultojnë nga konteksti i vendimeve të analizuara, në të cilat rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi elementëve të tillë si: disponibiliteti i padisë nga ana e paditësit, barra e provës, kontradiktoriteti, etj.
 - *Parimi i interesit më të lartë të fëmijës*, i cili referohet në drejtim të konkluzionit mbi përcaktimin e marrëdhënies së fëmijës së mitur me paditësen, si personi që kërkon t'i lihet fëmija për rritje dhe edukim.⁴⁷
- *Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.*

Në disa nga vendimet e analizuara, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet që lidhen me:

- *Gjykimin e shkurtuar dhe kushtet e aplikimit të tij*. Rezulton se nga ana e gjyqtarës është cituar dhe zbatuar në drejtim të vlerësimit për pranimin e kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar, vendimi unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;⁴⁸
- *Vlerësimin e bashkëpunimit* si element cilësues i veprës penale, gjyqtarja ka referuar dhe zbatuar praktikën unifikues të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 4, datë 15.4.2011;⁴⁹
- Në lidhje me rëndësinë e kualifikimit të marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur konflikti midis palëve, gjyqtarja referohet në vendimin unifikues nr. 74, datë 07.10.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;⁵⁰

⁴⁶ Vendimi nr.58/22-2015-441, datë 23.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

⁴⁷ Vendimi nr.91/22-2016-192, datë 15.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

⁴⁸ Vendimi nr.58/22-2015-441, datë 23.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

⁴⁹ Vendimi nr.58/22-2015-441, datë 23.12.2015, vendimi nr. 14, datë 10.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

⁵⁰ Vendimi nr.69/22-2016-143, datë 11.05.2016, vendimi nr. 113/22-2016-244, datë 19.07.2016, vendimi nr. 11/22-2016-24, datë 26.01.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi interpretimit të ligjit të zbatueshëm, i cili në disa raste bëhet në mënyrë të pavarur, para aplikimit mbi faktet e çështjes, dhe në raste të tjera si pjesë e integruar analizës ligjore, së bashku me faktin përkatës. Në disa prej vendimeve të analizuara, konkluzioni arrihet nga analiza dhe vlerësimi i faktit, duke aplikuar drejtpërdrejt ligjin e zbatueshëm, pa një interpretim paraprak dhe të pavarur të tij, pa bërë zbërthimin e të gjithë elementëve të normës (ligjit të identifikuar si të zbatueshëm), kjo nisur edhe nga natyra jo komplekse e disa çështjeve të trajtuara. Në pjesën tjetër të vendimeve të analizuara, analiza se si dispozitat ligjore relevante zbatohen mbi rrethanat faktike të provuara, nënkuptohet nga konkluzioni që ka arritur gjyqtarja pas citimit të ligjit, pasi mungon interpretimi i dispozitave përkatëse me qëllim dhënien e kuptimit të tyre, para aplikimit mbi faktet konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se "Gjyqtarja Rezarta Aliu ka aftësi për arsyetimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare. Ajo respekton rregullat e drejtshkkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksionet qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura e vendimeve të saj është mesatare nga pikëpamja e organizimit dhe nuk është e standardizuar në çdo rast. Në disa raste, pjesa arsyetuese paraqitet me tekst unik (shih 3 dokumentet dhe dosjen

3), ndërsa në disa raste të tjera, ajo organizohet me nënpjesë të emërtuara me tituj (shih dosjet 1, 2, 4 dhe 5). Në ndonjë rast, ajo përdor teknikën e numërtimit të paragrafëve (shih dokumentin 1).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Gjyqtarja, përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip, në mënyrë të veçantë konstatohet se në të gjitha vendimet gjyqësore përdoren shkronjat shqipe (ë dhe ç); Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma teknikë, apo fjalë që krijojnë konfuzion lidhur me kuptimin dhe kontekstin e përdorimit të tyre.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, gjyqtarja i referon ato në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalët janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin "Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se "Vendimet e saj përfundimtare janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit procedural civil (shih dokumentin 1, si dhe dosjet 1, 2 dhe 3) apo të legjislacionit procedural penal (shih dokumentet 2 dhe 3, si dhe dosjet 4 dhe 5). Pjesa hyrëse paraqitet e plotë me të gjitha të dhënat identifikuese të çështjes, duke përfshirë edhe kërkimet përfundimtare të palëve, të cilat në ndonjë rast nuk tregohen shprehimisht (shih dosjet 1 dhe 2). Në pjesën arsyetuese, ajo fillon gjithnjë vendimin me parashtrimin e çështjeve procedurale, që nga regjistrimi i çështjes, juridiksioni gjyqësor, kompetenca lëndore dhe tokësore, formimi i trupit gjykues, ndarja e çështjeve (kur është vendosur një gjë e tillë) dhe disponimi mbi kërkesën për gjykimin e shkurtuar penal (kur është kërkuar një gjë e tillë). Kjo paraqitje është e standardizuar prej saj dhe e mbushur me argumente juridike dhe referenca ligjore, edhe kur palët nuk i kanë kundërshtuar çështje të tilla, që e rendon tekstin e vendimit dhe vështirëson kuptimin e tij. Në ndonjë rast, teksti i vendimit për këtë pjesë ngjan me procesverbalin gjyqësor (shih dokumentet 2 dhe 3). Në vijim, ajo përcakton faktin e mosmarrëveshjes, tregon pretendimet e palëve (të cilat paraqiten gjerësisht, madje edhe se si ato kanë qenë në fillim të gjyqimit gjer në diskutimin përfundimtar), tregon provat dhe jep arsye mbi pranimin e vlerës së tyre, si dhe përfundon me analizën ligjore. Konstatohet tejzgjatje e tekstit të vendimit, ku teksti i ligjit, edhe pse palët nuk pretendojnë zbatim të ndryshëm të tij, paraqitet i plotë apo ku përmbajtja e provave jepet edhe për pjesët që nuk janë relevante për mosmarrëveshje. Konstatohet edhe mbivendosje e informacionit, që nga njëra ane tregon përpjekjet e gjyqtarës për të arsyetuar me detaje, por nga ana tjetër, vështirëson kuptimin dhe përdorimin e vendimit. Ajo i kushton rëndësi analizës së normës ligjore tek të gjithë konceptet dhe institutet kyçë dhe kur është rasti, për interpretimin e ligjit përdor parime të përgjithshme të së drejtës apo jurisprudencë të gjykatave më të larta. Referencat e përdorura prej saj janë të plota dhe të sakta. Në një rast, kur ka shqyrtuar kërkesëpadinë për zgjidhje martese, nuk tregohen provat, mbi të cilat gjykata është bazuar për të caktuar masën e detyrimit për ushqim për të miturin (shih dosjen 3). Në vendimet e gjyqtarës Rezarta Aliu, dispozitivi është i plotë dhe i qartë, duke përmbajtur jo vetëm disponimin kryesor, por edhe efektet dytësore të zgjidhjes së çështjes (siç janë dërgimi i vendimit për regjistrim në gjendje civile, disponimi për provat materiale apo për vendin e vuajtjes së dënimit gjer tek shpenzimet procedurale). Në një rast është konstatuar se është disponuar për pushimin e çështjes penale për akuzën e nenit 134/3 të K.Penal, por shkak

i pushimit nuk citohet në dispozitiv sipas nenit 387 të K.Pr.Penale (shih dokumentin 3). Në rastin, kur gjyqtarja lëshon edhe urdhrin e ekzekutimit, nuk shënon që urdhri lëshohet vetëm në një kopje dhe nuk tregon zyrën e përmbarimit që urdhërohet për zbatimin e vendimit (shih dokumentin 1 dhe dosjen 3). Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Vendimet e saj janë gjithëpërfshirëse në raport me kërkimet dhe prapësimet e palëve. Dispozitivi është rrjedhojë e pjesës arsyetuese”.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtarja ka një metodologji të qartë, duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Konkretisht, në mënyrë më specifike konstatohet **në çështjet civile** se: Vendimi gjyqësor përmban përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, koha dhe vendi i zhvillimit të gjykimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

Në pjesën e vendimit ku pasqyrohet trupi gjykues, konstatohet që gjyqtarja vendos në vendim dy mbiemra: Referuar nenit 51 të Kodit të Familjes, bashkëshortët, kur lidhin martesën, kanë të drejtë të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre, ose të mbajnë secili mbiemrin e vet. Në certifikatën familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, me nr. , datë 07.10.2013, konstatohet që gjyqtarja ka zgjedhur të mbajë si mbiemër “Aliu”. Në zbatim të nenit 6§3 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i cili parashikon që elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të njëjtave elemente të çdo akti tjetër, shtetëror ose privat dhe janë të detyrueshme të respektohen, në pjesën e vendimit ku pasqyrohet trupi gjykues duhet të vendoset vetëm mbiemri

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë (përgjithësisht të listuara si “rrethanat e faktit”, dhe “analiza juridike e çështjes”), ku në mënyrë të detajuar gjyqtarja analizon: (i) rrethanat procedurale, në të cilën gjyqtarja rendit çështjet e kompetencës dhe juridiksionit (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (iii) pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (iv) ligjin e zbatueshëm dhe (v) vlerësimin e gjykatës, ku gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët

e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionet e saj.

Pjesa e dispozitivit është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me objektin e padisë, si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, si dhe data e shpalljes së vendimit. Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile.

Po kështu, edhe në **çështjet penale** konstatohet se: Vendimi gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Pjesa hyrëse përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues dhe sekretaren gjyqësore, kohën e zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë, nenin përkatës të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimit është e ndarë në disa pjesë, ku në mënyrë të detajuar analizon: (i) Procedurën, në të cilën gjyqtarja përshkruan në mënyrë kronologjike ecurinë procedurale çështjes, duke filluar me paraqitjen e çështjes në gjykatë, shqyrtimin kryesisht të përcaktimit të kompetencës lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes, si dhe disponimin e gjykatës lidhur me kërkesën paraprake të të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar, ndarjen e çështjes etj. (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes, gjyqtarja përshkruan faktin penal objekt akuze, në përputhje dhe të integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. (iii) Pretendimet e palëve gjatë gjykimit (iv) Vlerësimi dhe analiza juridike, ku gjyqtarja bën analizën ligjore mbi provat dhe cilësimin juridik të veprës penale, si dhe caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, ku në fund evidentohen edhe disponimet lidhur me kërkesën për shpenzimet procedurale dhe ato gjyqësore.

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurit, akuzën përkatëse, nenin respektiv të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, mënyrën e vuajtjes së dënimit, shpenzimet gjyqësore dhe hetimore, të drejtën e ankimit, si dhe vendimin dhe vendin dhe datën e shpalljes së vendimit. Konstatohet se në çështjet e kategorisë “Krime”, vendimet përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383/ç të K.Pr.Penale.

Gjyqtarja ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, siç citohet më sipër, sipas pjesëve të vendimit, ku gjyqtarja zbaton rregullat e shkrimit ligjor, duke identifikuar

faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi "Shumë e lartë" në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit sipas pjesëve përbërëse të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se "Gjyqtarja ka aftësi për arsyetimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare..... Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat në asnjë rast nuk mungon shkaku ligjor (shih 5 dosjet e vëzhguara)".

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se përgjithësisht, gjyqtarja paraqet një analizë të strukturuar të fakteve të çështjes, identifikon, citon dhe në disa raste analizon ligjin e zbatueshëm, e aplikon atë mbi faktet e çështjes dhe parashtron argumentet mbi mënyrën e zbatimit të ligjit, duke lidhur këto argumente me konkluzionet e arritura mbi kërkimet objekt padie, pretendimet e palëve, apo konkluzionin e saj mbi çështjet penale të shqyrtuara.

Kryesisht, në vendimet penale të themelit, gjyqtarja i kushton një vëmendje më të posaçme arsytimit të vendimeve, dhënies së argumenteve ligjore të plota lidhur me faktin penal objekt akuze, provueshmërinë e tij, cilësimin ligjor të faktit, si dhe autorësinë e të pandehurit. Në vendimet civile, cilësia e arsytimit dhe niveli i argumentimit logjik janë më të dukshme në disa prej vendimeve,⁵¹ ndërsa në vendimet e tjera arsytimi përqendrohet kryesisht në paraqitjen dhe analizën e rrethanave të provuara në gjykim, në raport me kërkimin objekt padie, pa u ndalur në mënyrë të posaçme në dhënien e argumenteve të zgjeruara ligjore mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktet konkrete. Në këto vendime, ligji material dhe dispozitat procedurale referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, duke u lidhur menjëherë me konkluzionin e arritur, pa u ndalur në interpretimin e ligjit dhe integrimin e tij me argumentet e gjyqtarës mbi faktet e çështjes. Megjithatë, duhet theksuar se cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik në një pjesë të vendimeve të analizuara, kryesisht disa prej vendimeve civile, është i kushtëzuar dhe nga natyra e mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila në këto raste ka natyrë të thjeshtë, duke kufizuar nevojën e kryerjes së një analize të zgjeruar ligjore.

Përgjithësisht, arsytimi i vendimeve paraqitet i plotë dhe i qartë, duke i kushtuar rëndësi argumentimit më të plotë dhe gjithëpërfshirës, veçanërisht në rastet kur ka qenë e nevojshme për shkak të ekzistencës së elementëve të diskutueshëm në raport me faktin penal ose civil objekt shqyrtimi. Në tërësi, arsytimi i vendimeve ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore në aspektin procedural dhe material civil apo penal, duke u ndalur në analizën dhe argumentimin e zgjeruar të tyre vetëm në disa raste, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Pavarësisht natyrës komplekse ose jo të çështjes, gjyqtarja ka evidentuar në çdo rast në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar më pas arsytimin e vendimit, interpretimin e ligjit dhe përqasjen e tij të drejtpërdrejtë me faktin e provuar në gjykim, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Në disa prej vendimeve të analizuara rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës penale dhe civile, kur kjo rezulton e nevojshme, në shërbim të përcaktimit të natyrës së çështjes ose konkluzioneve të arritura lidhur me të, si p.sh: (i) *Instituti procedural të padisë*, posaçërisht të padisë së njohjes, sipas parashikimeve të nenit 32/c të K.Pr.Civile dhe interesit të ligjshëm në ngritjen e kësaj padie;⁵² (ii) *Instituti i martesës dhe zgjidhjen e saj*, në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes

⁵¹ Vendimi nr.69/22-2016-143, datë 11.05.2016, vendimi nr. 5, datë 14.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

⁵² Vendimi nr. 142/22-2015-240, datë 08.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

së martesës, duke i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak – pasojë;⁵³ (iii) *Instituti të dënimit dhe qëllimit të tij*, kushtet dhe kriteret për përcaktimin dhe individualizimin e dënimit, si dhe analizën e tyre në raport me rrethanat për të pandehurin konkret, në përputhje me provat dhe rrethanat e provuara në gjykim.⁵⁴

Pavarësisht peshës së arsytimit ligjor, e cila nuk është e njëjtë në të gjitha vendimet e analizuara, në çdo rast mënyra e organizimit dhe paraqitjes së analizës së faktit dhe ligjit, si dhe argumentimit, përmban lidhjen logjike shkak-pasojë, mes çështjeve të shtruar për zgjidhje, referuar objektit të padisë civile ose objektit të çështjes penale, me konkluzionet e arritura nga gjyqtarja. Kjo lidhje në disa vendime vjen si pasojë e aplikimit të drejtpërdrejtë të ligjit të zbatueshëm mbi faktet e provuara në gjykim dhe në disa prej vendimeve vjen si pasojë e një analize më të plotë mbi interpretimin dhe dhënien e arsyeve të mënyrës së zbatimit të ligjit mbi faktet, në shërbim të konkluzioneve të arritura.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të mira në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, aftësi të cilat reflektohen në mënyrë më të plotë në disa prej vendimeve të analizuara, kryesisht në vendimet penale të themelit dhe në disa prej vendimeve civile të analizuara, ndërkohë që në pjesën tjetër të tyre analiza është e qartë, por nuk reflekton të njëjtën shkallë kujdesi për pasurimin e saj me elementë cilësorë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtares”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	95

⁵³ Vendimi nr. 91/22-2016-192, datë 15.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

⁵⁴ Vendimet nr.27, datë 22.04.2014; nr.58/22-2015-441, datë 23.12.2015; nr. 34/22-2015-261, datë 24.04.2015; nr. 41/22-2015-334, datë 06.10.2015, nr. 14, datë 10.03.2014, nr. 26, 21.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Në të 5 këto raste është respektuar afati ligjor apo standard i gjykimit. Kohëzgjatja e gjykimit është analizuar edhe tek 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vete subjekti i rivlerësimit, ku është konstatuar se ka qenë 6 muaj e 9 ditë, duke tejkaluar vetëm me 9 ditë afatin standard 6 mujor (shih dokumentin 1) dhe 4 muaj e 23 ditë, brenda afatit standard (shih dokumentin 3). Ndërsa në 1 prej këtyre dokumenteve, kohëzgjatja nuk mund të përcaktohej, pasi në tekstin e vendimit nuk është shënuar data e regjistrimit të çështjes (shih dokumentin 2). Rrjedhimisht, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Rezarta Aliu respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektin e kohëzgjatjes së gjykimit”.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues

do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu, edhe për çështjet civile, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për asnjë prej tyre nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat nuk parashikohet ndonjë afat ligjor për përfundimin e tyre aftësia e gjyqtarës në lidhje me këtë tregues, pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin "Respektimi i afateve ligjore", gjyqtarja vlerësohet "0-10%", duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përsheptuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues

do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 2 vendimeve⁵⁵ të përzgjedhura nga gjyqtarja, si dhe të dhënave të analizuara në Aktin e Vlerësimit të Përshpejtuar për vitin 2014.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *"Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja ka qenë në intervale kohore nga 28 ditë (shih dosjen 1) deri në 3 muaj e 8 ditë (shih dosjen 5). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 10 ditë (shih dosjen 2), 1 muaj e 20 ditë (shih dosjen 3) dhe 2 muaj e 27 ditë (shih dosjen 4). Në të 5 këto raste është respektuar afati ligjor apo standard i gjykimit. Kohëzgjatja e gjykimit është analizuar edhe tek 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, ku është konstatuar se ka qenë 6 muaj e 9 ditë, duke tejkaluar vetëm me 9 ditë afatin standard 6 mujor (shih dokumentin 1) dhe 4 muaj e 23 ditë, brenda afatit standard (shih dokumentin 3). Ndërsa në 1 prej këtyre dokumenteve, kohëzgjatja nuk mund të përcaktohej, pasi në tekstin e vendimit nuk është shënuar data e regjistrimit të çështjes (shih dokumentin 2). Rrjedhimisht, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Rezarta Aliu respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektin e kohëzgjatjes së gjykimit"*.

Në aktin e vlerësimit të përshpejtuar për periudhën e vlerësimit janar-dhjetor 2014, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *"Në vitin 2014, gjyqtarja ka gjykuar në total 10 çështje gjyqësore (2 çështje civile me palë kundërshtare, 1 çështje administrativo-penale, 2 çështje penale themeli dhe 5 çështje civile pa palë kundërshtare) jashtë afateve standarde të Sistemit të Vlerësimit. Këto 10 çështje gjyqësore në raport me 35 çështje gjyqësore të gjykuara gjithsej prej saj në vitin 2014 zënë masën 28.5%. Nga inspektimi i 1 çështjeje të zvarritur të përzgjedhur me short, evidentohen si shkaqe zvarritje: (i) marrja e provave; (ii) thirrja dhe njoftimi i palëve të larguara jashtë shtetit; dhe (iii) mungesa e gjyqtarës për arsye shëndetësore. Rrjedhimisht për aspektin kohor gjyqtarja Rezarta Aliu klasifikohet me vlerësimin Pranuëshëm, duke marrë në konsideratë edhe ngarkesën sasiore të saj shumë të ulët"*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur përgjithësisht brenda standardeve minimale kohore, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD, dhe duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve rezulton:

⁵⁵ Vendimi nr. 14, datë 10.03.2014 i përzgjedhur nga gjyqtarja nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes, në këto kushte nuk mund të përcaktohet kohëzgjatja e gjykimit të kësaj çështje.

Cështje civile:

- Dosja 1 - *(është caktuar me short në datën 16.12.2014 dhe ka përfunduar në datën 14.01.2014)* Gjykimi ka zgjatur 29 ditë, brenda afatit 2 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile pa palë kundërshtare;
- Dosja 2 - *(është caktuar me short në datën 20.04.2016 dhe ka përfunduar në datën 01.06.2016)* Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 12 ditë, brenda afatit 2 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile pa palë kundërshtare;
- Dosja 6 - *(është caktuar me short në datën 28.01.2013 dhe ka përfunduar në datën 10.02.2014)* Gjykimi ka zgjatur 1 vit e 13 ditë, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;

Duke patur parasysh se çështja ka për objekt pjesëtimin e pasurisë, e cila kalon në dy faza gjykimi dhe faza e dytë e gjykimit fillon në momentin që vendimi i fazës së parë merr formë të prerë, atëherë afati i gjykimit do të llogaritet duke zbritur fazën e ndërmjetme të komunikimit të vendimit të fazës së parë. Konkretisht, afati i gjykimit do të llogaritet nga data e caktimit të çështjes me short, deri në datën e përfundimit të fazës së parë të pjesëtimin të pasurisë (28.01.2013–10.07.2013) dhe nga data e marrjes së vendimit formë të prerë, deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar (03.09.2013-10.02.2014). Pra, gjykimi ka zgjatur 10 muaj e 19 ditë, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile.

- Dosja 8 - *(është caktuar me short në datën 30.03.2015 dhe ka përfunduar në datën 08.07.2015)* Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 8 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 10 - *(është caktuar me short në datën 13.04.2016 dhe ka përfunduar në datën 19.07.2016)* Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 6 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 11 - *(është caktuar me short në datën 07.12.2015 dhe ka përfunduar në datën 26.01.2016)* Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 19 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Vendimi 1 - *(është regjistruar në datën 02.11.2015 dhe ka përfunduar në datën 11.05.2016)* Gjykimi ka zgjatur 6 muaj e 9 ditë, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile (tejkallim vetëm me 9 ditë).

Cështje penale:

- Dosja 4 - *(është caktuar me short në datën 27.04.2015 dhe ka përfunduar në datën 21.07.2015)* Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 24 ditë, brenda afatit 4 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë kundërvajtje);
- Dosja 5 - *(është caktuar me short në datën 13.01.2014 dhe ka përfunduar në datën 11.04.2014)* Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 8 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);

- Dosja 7 - (është caktuar me short në datën 13.01.2014 dhe ka përfunduar në datën 22.04.2014) Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 9 ditë, brenda afatit 9 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 9 - (është caktuar me short në datën 15.06.2015 dhe ka përfunduar në datën 06.10.2015) Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 21 ditë, brenda afatit 9 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Vendimi 3 - (është regjistruar në datën 30.07.2015 dhe ka përfunduar në datën 23.12.2015) Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 23 ditë, brenda afatit 9 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

Cështje familjare:

- Dosja 3 - (është caktuar me short në datën 25.04.2016 dhe ka përfunduar në datën 15.06.2016) Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 21 ditë, brenda afatit 4 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet familjare;

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga çështjet e analizuarra për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, përfshirë këtu edhe çështjet e analizuarra në raportin e vlerësimit të vitit 2014 (në përlogaritje nuk janë marrë parasysh çështjet e përzgjedhura me short të cilat i përkasin vitit 2014, për shkak se këto çështje përfshihen edhe në raportin e vlerësimit të vitit 2014), rezulton se 10 (dhjetë) çështje civile ose 23.25% e tyre kanë përfunduar tej afatit standard minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.

Përqindja matematikore prej 23.25% përkon me nivelin e vlerësimit 3 (tre) pikë, por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Pavarësisht se për 23.25% të çështjeve të shqyrtuara, rezulton tejkalimi i standardit minimal kohor të pranuar prej 6 muajsh, rezulton se kjo nuk është pasojë e mosmenaxhimit efektiv të procesit, por pasojë e ecurisë procedurale të çështjes. Edhe në raportin e vlerësimit të vitit 2014 lidhur me analizimin e ecurisë së çështjes konkludohet se: “Nga inspektimi i 1 (një) çështje të zvarritur të përzgjedhur me short, evidentohen si shkaqe zvarritje: (i) marrja e provave; (ii) thirrja dhe njoftimi i palëve të larguara jashtë shtetit; dhe (iii) mungesa e gjyqtarës për arsye shëndetësore”. Nga ana tjetër, në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 225 çështje, nga të cilat 167 çështje⁵⁶ kanë qenë çështje me palë kundërshtare, mesatarisht 56 çështje themeli në vit,⁵⁷ ndërkohë që për periudhën 10.06.2014-01.03.2015 gjyqtarja ka qenë larguar me leje lindje.

⁵⁶ 50 penale; 91 civile; 2 urdhër mbrojtje dhe 24 familjare.

⁵⁷ Gjyqtari i shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje, penale (krime dhe kundravajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare.

KONKLUZIONE

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuara, që rezultojnë në masën 23.25%; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit, të cilat, nga dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarës dhe (iii) standardi sasior i punës i cili është dukshëm më i ulët se ngarkesa minimale e përcaktuar me Vendimin nr.261/2 të KLD, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet në një nivel më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin "Respektimi i standardeve minimale kohore" në kushtet kur përqindja e çështjeve të gjykuara tej standardit minimal është 23.25%, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe procedurale që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. gjyqtarja pikëzohet me 4 pikë.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se "Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Rezarta Aliu ka qenë në intervale kohore nga 28 ditë (shih dosjen 1) deri në 3 muaj e 8 ditë (shih dosjen 5). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 10 ditë (shih dosjen 2), 1 muaj e 20 ditë (shih dosjen 3) dhe 2 muaj e 27 ditë (shih dosjen 4). Në të 5 këto raste është respektuar afati ligjor apo standard i gjykimit. Kohëzgjatja e gjykimit është analizuar edhe tek 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vete subjekti i rivlerësimit, ku është konstatuar se ka qenë 6 muaj e 9 ditë, duke tejkaluar vetëm me 9

ditë afatin standard 6 muaj (shih dokumentin 1) dhe 4 muaj e 23 ditë, brenda afatit standard (shih dokumentin 3). Ndërsa në 1 prej këtyre dokumenteve, kohëzgjatja nuk mund të përcaktohet, pasi në tekstin e vendimit nuk është shënuar data e regjistrimit të çështjes (shih dokumentin 2). Rrjedhimisht, konstatohet se subjekti i rivlerësimit .

respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektin e kohëzgjatjes së gjykimit”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve.

Në “Aktin e vlerësimit të përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, të gjyqtarës Rezarta Aliu, konstatohet se “Në vitin 2014, gjyqtarja . ka gjykuar në total 10 çështje gjyqësore (2 çështje civile me palë kundërshtare, 1 çështje administrativo-penale, 2 çështje penale themeli dhe 5 çështje civile pa palë kundërshtare) jashtë afateve standarde të Sistemit të Vlerësimit”. Këto të dhëna të referuara në aktin e vlerësimit nuk mund të merren në analizë lidhur me kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, për shkak se përveç konstatimit se janë gjykuar tej afateve të standardeve minimale të gjykimit, nuk referohen të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve.

Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit.⁵⁸

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (nga 13 çështjet e marra në analizë, nga të cilat 1 çështje familjare, 5 çështje penale themeli, 7 çështje civile themeli), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Familjare”, rezulton të jetë 2 muaj e 21 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e mosmarrëveshjeve familjare.⁵⁹
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 5 (pesë) çështje në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë 3 muaj e 13 ditë, pra më e shkurtër

⁵⁸ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

⁵⁹ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “d. Gjykimet e mosmarrëveshjeve familjare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj”.

se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale krime në Gjykatën e Shkallës së Parë.⁶⁰

- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 7 (shtatë) çështje në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë 117 ditë, rreth 3 muaj e 27 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.⁶¹

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, në kushtet kur ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: *“Subjekti rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, e cila nuk ka qenë e organizuar në seksione. Ajo ka deklaruar se gjatë periudhës së rivlerësimit i janë caktuar 283 çështje, ka përfunduar 222*

⁶⁰ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “*a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.* Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “*e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshme, jo më tej se 6 muaj”.*

çështje dhe ka mbartur 14 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 78.4%".

Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga gjykatat për numrin e çështjeve të caktuara dhe atyre të përfunduara, rezulton se gjyqtarës për gjithë periudhën e vlerësimit i janë caktuar në total 283 çështje dhe ka përfunduar 225 prej tyre. Nga rillogaritja e rendimentit sipas këtyre të dhënave, rezulton një normë likuidimi çështjesh prej 79.5%.

KONKLUZIONE

Referuar akteve të depozituara nga gjyqtarja në mbështetje të kundërshtimeve të paraqitura, rezulton se gjatë vitit 2014 gjyqtarja ka ushtruar detyrën e gjyqtarës për vetëm rreth 3 muaj (*gjatë muajt janar ka qenë me raport për arsye shëndetësore në datat 23-24, 27-31; në muajin maj ka qenë me raport në datat 5-13, 19-23 dhe 28-29; në muajin qershor ka qenë me leje nga data 2-3, dhe me raport 4-6 qershor, për t'u shkëputur me leje lindje në 11 qershor*). Për rrjedhojë, çështjet e caktuara gjatë vitit 2014 (70 çështje), nuk mund të përfundonin për një periudhë kohore të barabartë me 3 muaj, kohë kjo më e shkurtër se standardi minimal kohor për kategoritë e çështjeve civile me palë kundërshtare, apo kategorinë e çështjeve penale krime apo kundërvajtje. Meqenëse ky fakt ndikon në llogaritjen matematikore të rendimentit të çështjes, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet në nivelin "Mbi 87-93%", por nuk pikëzohet në nivelin maksimal, për shkak se standardi sasior i punës së gjyqtarës është dukshëm më i ulët se ngarkesa minimale e përcaktuar me Vendimin nr.261/2 të KLD.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin "Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore" vlerësohet "Mbi 81-87%", duke e pikëzuar me 6 pikë.*

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, i miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se “Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja i ka kushtuar rendësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 2 ditë nga shpallja (shih dosjen 3), për 3 ditë nga shpallja (shih dosjen 4), për 6 ditë nga shpallja (shih dosjen 2), për 9 ditë nga shpallja (shih dosjen 5 - penale) dhe për 10 ditë nga shpallja (shih dosjen 1). Siç konstatohet, ajo ka tejkaluar afatin ligjor vetëm në 1 rast, por vonesa ka qenë e parëndësishme, vetëm për 4 ditë (shih dosjen 5)”.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 5, datë 14.01.2014, është dorëzuar në datën 24.01.2014 - (10 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;

- Dosja 2, që i përket vendimit me nr.168, datë 01.06.2016 është dorëzuar në datën 06.06.2016 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 192, datë 15.06.2016 është dorëzuar në datën 17.02.2016 - (2 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 4, që i përket vendimit me nr. 261, datë 21.07.2015 është dorëzuar në datën 23.07.2015 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 5, që i përket vendimit me nr. 26, datë 21.04.2014 është dorëzuar në datën 30.04.2014 - (9 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 01.07.2021, rezulton se:

- Dosja 6, që i përket vendimit me nr. 11, datë 10.02.2014 është dorëzuar në datën 17.02.2014 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 7, që i përket vendimit me nr.27, datë 22.04.2014 është dorëzuar në datën 07.05.2014 - (15 ditë), jashtë afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 8, që i përket vendimit me nr.142/22-2015-240, datë 08.07.2015 është dorëzuar në datën 15.07.2015 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 9, që i përket vendimit me nr.41/22-2015-334, datë 06.10.2015 është dorëzuar në datën 09.10.2015 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 10, që i përket vendimit me nr.113/22-2016-244, datë 19.07.2016 është dorëzuar në datën 22.07.2016 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 11, që i përket vendimit me nr.11/22-2016-24, datë 26.01.2016 është dorëzuar në datën 01.02.2016- (6 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se për çështje të kategorisë "Civile themeli", koha mesatare e arsytimit është 5.7 ditë; për çështje të kategorisë "Penale krime", koha mesatare e arsytimit është 7.5 ditë.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton "Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve".

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar" vlerësohet "Më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve", duke e pikëzuar me 15 pikë.



2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se "Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në 2 çështje civile ajo ka kryer rregullisht veprimet përgatitore (shih dosje 1 dhe 2), ndërsa në 1 çështje për zgjidhje martesë, ka kryer veprimet e pajtimit, duke urdhëruar rregullisht ri thirrjen e të paditure si konform nenit 135 paragrafi 2 i K.Familjes (shih dosjen 3). Veprimet përgatitore apo të pajtimit janë dokumentuar rregullisht me procesverbal. Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 2 seanca (shih dosjen 1), me 3 seanca (shih dosjen 2), me 4 seanca (shih dosjen 3), me 9 seanca (shih dosjen 4) dhe me 11 seanca (shih dosjen 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 29 seanca gjyqësore, nga të cilat 16 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 3 seanca joproductive kanë qenë mosparaqitja e nalëve (1 seance), njoftimi i të pandehurit (6 seanca), thirrja dhe njoftimi i mbrojtësit (3

seanca), kërkesa e mbrojtësit për t' u njohur me aktet e çështjes (1 seancë) , mungesa e gjyqtarës (1 seancë), mungesa e prokurorit (1 seancë), largimi i mbrojtëses pas debatit me prokurorin (1 seancë) dhe pa përgatitja e diskutimit përfundimtar nga prokurori (1 seancë). Gjyqtarja ka mbikëqyrur aktet e njoftimit, për të shmangur pengesat lidhur me to. Në një rast, ajo ka reaguar për njoftimin e të pandehurit nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore, duke ndjekur edhe vënien në dijeni të hallkave hierarkike në policinë e shtetet, gjer tek Ministri i Brendshëm, por urdhrat e saj nuk janë zbatuar (shih dosjen 4) ”.

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtare, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, të administruara në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1 – që i përket çështjes civile, me nr. (286) 36 regjistri, datë regjistrimi 18.12.2013, me objekt “Autorizim për tjetërsim pasurie”, përfunduar me vendimin nr. 5, datë 14.01.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar vetëm 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, përsa kohë ka përfunduar edhe me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 2 – që i përket çështjes civile, me nr.101 regjistri, datë regjistrimi 20.04.2016, me objekt “Vërtetim fakti juridik”, përfunduar me vendimin nr.168, datë 01.06.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dv) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive.
- Dosja 3 – që i përket çështjes civile, me nr. 105 regjistri, datë regjistrimi 25.04.2016, me objekt “Zgjidhje martesë”, përfunduar me vendimin nr.192, datë 15.06.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dv) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive.
- Dosja 4 – që i përket çështjes penale, me nr.28 regjistri, datë regjistrimi 24.04.2015, përfunduar me vendimin nr.261, datë 21.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 9 (nëntë) seanca gjyqësore nga të cilat 5 (pesë) seanca kanë rezultuar joproductive, për mosparaqitjen e të pandehurit apo të mbrojtësit të caktuar. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: lënien kohë mbrojtësit të njihet me aktet e dosjes, lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim.
- Dosja 5 – që i përket çështjes penale, me nr.20 regjistri, datë regjistrimi 06.01.2014, përfunduar me vendimin nr.26, datë 21.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 12 (dymbëdhjetë) seanca gjyqësore nga të cilat 3 (tre) seanca kanë rezultuar joproductive, për mosformim të trupit gjykues

(*gjiqtarja me raport*), për mosparaqitjen e prokurorit, për mosparaqitjen e mbrojtësit të të pandehurit. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimin e dëshmitarëve, lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

➤ Dosja 6 – që i përket çështjes civile, me nr. 73 (05) regjistri, datë regjistrimi 31.01.2013, me objekt “Pjesëtim pasurie”, përfunduar me vendimin nr.11, datë 10.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 14 (katërbëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 5 (pesë) seanca kanë rezultuar joproduktive, për mosrealizimin e njoftimit për palën e paditur, për mosparaqitjen e palës paditëse, për mosformim të trupit gjykues, si dhe për shkak të festës zyrtare. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimi i ekspertit dhe lënia kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit, për hartimin e projektjesëtimimit, lënien kohë palëve për të parashtruar me shkrim mendimin lidhur me projektjesëtimin.

➤ Dosja 7 – që i përket çështjes penale, me nr. 21 regjistri, datë regjistrimi 06.01.2014, përfunduar me vendimin nr.27, datë 22.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 7 (shtatë) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm një seancë ka qenë joproduktive, për mosformim të trupit gjykues. Të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: lënien kohë mbrojtësit për t’u njohur me aktet e fashikullit penal, për të njoftuar dëshmitarët, si dhe lënien kohë palëve për të përgatitur diskutimin përfundimtar.

➤ Dosja 8 – që i përket çështjes civile, me nr. 133/3108-00066 regjistri, datë regjistrimi 01.04.2015, me objekt “Deklarimin e pavërtetësisë së dokumentit”, përfunduar me vendimin nr.142/22-2015-240, datë 08.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka qenë joproduktive, për mosparaqitje të përfaqësuesit të palës paditëse. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale.

➤ Dosja 9 – që i përket çështjes penale, me nr.37/59301-00046-22-2015 regjistri, datë regjistrimi 15.06.2014, përfunduar me vendimin nr.41/22-2015-334, datë 06.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 8 (tetë) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka qenë joproduktive, për mosparaqitjen e mbrojtësit të të pandehurit. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: lënien kohë mbrojtjes për të përgatitur mbrojtjen, për të njoftuar dëshmitarët, lënien kohë palëve për të përgatitur diskutimet përfundimtare.

➤ Dosja 10 – që i përket çështjes civile, me nr.93/212400-00076-22-2016 regjistri, datë regjistrimi 13.04.2016, me objekt “Lirim, dorëzim sendi” përfunduar me vendimin nr.113/22-2016-244, datë 19.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që

për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 8 (tetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 3 (tre) seanca kanë qenë joproduktive, për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse apo të paditur.

➤ Dosja 11 – që i përket çështjes civile, me nr. 29 (288/21279-00274-22-2015) regjistri, datë regjistrimi 07.12.2015, me objekt “Detyrim pagim shume”, përfunduar me vendimin nr.11/22-2016-24, datë 26.01.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproduktive.

Nga tërësia e të dhënave siç parashtrohen më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 11 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtarë (penale themeli dhe civile themeli) varion nga 1, deri në 14 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 6.1 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile themeli dhe penale themeli) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore, duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile dhe nenin 33 e vijues dhe 342 të K.Pr.Penale). Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimi i mbrojtësit të caktuar kryesisht për të pandehurin, njoftimi i palëve të treta, njoftimi i kërkesës për shtimin e objektit të padisë, për të paraqitur prova në dobi të gjyqimit apo për të paraqitur konkluzionet përfundimtare me shkrim, etj. Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave përgatitore dhe të seancave gjyqësore, konstatohet respektimi në çdo rast i afatit të arsyeshëm, më i shkurtër se 15 ditë, për caktimin e seancave, në rastet kur ligji nuk ka parashikuar afat.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 11 çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 6.1 seanca, por rezulton që gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri i seancave gjyqësore është më i madh se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet "1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë", duke e pikëzuar me 15 pikë.



2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se "Ajo merr masat për caktimin e shpejtë të seancave gjyqësore, por duhet t' i kushtojë rendësi edhe të drejtës së palëve për t'u njoftuar në kohën e duhur. Kështu, në caktimin e seancës së parë gjyqësore në një çështje penale nuk është respektuar afati 10 ditor i nenit 333 pika 2 të K.Pr.Penale dhe seanca e pare ka dështuar sepse fletëthirrja drejtuar të pandehurit është kthyer me shënimin e shërbimit postar "afat i shkurtër" (shih dosjen 4). Gjyqtarja i kushton rendësi edhe caktimit të seancave vijuese në gjykim, ku zbaton parimin e shpejtësisë në gjykim, duke i caktuar seancat edhe të nesërmen nëse shkaku i shtyrjes së saj e lejon një gjë të tillë (shih dosjen 5). Një tipar pozitiv i punës së saj është zhvillimi i gjykimeve gjithmonë në sallë dhe regjistrimi i seancave me sistemin audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit. Është e vërtetë që në 1 çështje, vendi i zhvillimit të seancave nuk është dokumentuar dhe ato nuk janë regjistruar audio, pasi sistemi audio është instaluar në këtë gjykatë në datën 31.03.2014, pra pasi gjyqtarja kishte përfunduar këtë çështje (shih dosjen 1). Seancat e vëzhguara janë çelur duke respektuar përgjithësisht orarin e fillimit të tyre, me vonesa të papërfillshme gjer në 15 minuta. Në 1 rast, ka patur vonese prej 50 minutash

dhe si shkak është relatuar pjesëmarrja e gjyqtarës në një gjykim tjetër (shih dosjen 3). Në 1 rast tjetër, ka patur 1 orë e 29 minuta vonesë në çeljen e seancës dhe shkak nuk është dokumentuar (shih dosjen 4). Ndërsa në një çështje tjetër, në çeljen e 3 seanceve ka patur 20- 30 minuta vonese, ku shkak i vonesës në 2 prej tyre lidhej me gjykimet e tjera, ndërsa në 1 seancë nuk është relatuar shkak i vonesës (shih dosjen 5). Gjyqtarja zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Në të gjitha rastet, disponon me vendime të ndërmjetme e me shkak ligjor për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit. Gjithashtu, ka disponuar me vlerësimin psikologjik të të miturve (shih dosjen 3 dhe 5) apo me dëgjimin e të miturve nga gjykata në prani të psikologut (shih dokumentin 2 dhe dosjen 5)”.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Të gjitha çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, u përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare. Gjyqtarja në përgjithësi i ka vënë në lëvizje çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore në çështjet civile dhe caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale, në çdo rast, duke filluar që nga brenda ditës, deri në 3 ditë pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Seancat përgatitore dhe ato gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara përgjithësisht janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, duke u mbajtur me sistemin e regjistrimit audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Me përjashtim të dy prej çështjeve, në të cilat seancat përgatitore dhe ato gjyqësore janë dokumentuar në procesverbalin e mbajtur me dorëshkrim nga sekretarja gjyqësore, kjo për faktin se sistemi i regjistrimit audio në këtë gjykatë ka filluar të funksionojë pas regjistrimit të këtyre çështjeve në gjykatë.

Në çështjet civile: Përgjithësisht, rezulton që seancat gjyqësore të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre, relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni nga palët që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përlligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla, deklarimin të hapur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave, administrimin e provave, drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat, si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas

zhvillimit të debatit mbi provat, deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Në çështjen penale: Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet ligjore procedurale për gjykimin e zakonshëm. Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për të relatuar verifikimin e paraqitjes së palëve e të mbrojtësve, relatin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, si dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa nga 3 deri në 15 minuta, që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë, konstatohet se një numër i konsiderueshëm seancash të filluara me më shumë se 18 minuta me vonesë, deri në 1 orë 35 minuta me vonesë, nga ora e planifikuar. Në një rast, fillimi me 35 minuta vonesë ka sjellë joproduktivitetin e zhvillimit të seancës gjyqësore, për shkak se pala (i pandehuri) nuk ka qenë prezent. Shkaku i vonesës në zhvillimin e seancës gjyqësore, në rastet kur ai është realatuar nga gjyqtarja, lidhet me pjesëmarrjen e saj në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, apo mospasja e sallave të lira për gjykim.

KONKLUZIONE

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Numri i konsiderueshëm i seancave të filluara me vonesë në këtë rast, si dhe shtrirja kohore e vonesës, pavarësisht relimit ose jo të shkakut për palët prezent, është një e dhënë që në këtë rast nuk tregon shkallë shumë të lartë aftësie të gjyqtarës, në drejtim të planifikimit dhe mbikëqyrjes së fillimit në kohë të seancave gjyqësore. Nga ana tjetër, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke

respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil dhe penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi : Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin "Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor" vlerësohet "Mbi mesataren", duke e pikëzuar me 16 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *"Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se gjyqtarja ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në rastet kur seanca nuk është çelur pasi mungon gjyqtarja, është mbajtur procesverbal administrativ nga sekretarja gjyqësore për të pasqyruar këtë fakt dhe për të njoftuar palët për seancën vijuese. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadia apo kërkesa penale për gjykim, provat shkresore, aktet e ekspertimit (kur ka të tilla), kërkesat e palëve gjatë gjykimit (kur ato paraqiten me shkrim) , procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim dhe vendimet përfundimtare. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Lidhur me procesverbalin gjyqësor është konstatuar se shënohet saktësisht ora e fillimit dhe e përfundimit të seancës. Në 2 seanca, shkaku i vonesës nuk është dokumentuar në procesverbal (shih dosjet 4 dhe 5). Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar rregullisht aktet procedurale"*.

Nga vëzhgimi i dosjeve të I l çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të I l dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes në çështjen penale fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin e shortit, vijon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vendimin e gjyqtarës për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin "Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar; "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se gjyqtarja ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në rastet kur seanca nuk është çelur pasi mungon gjyqtarja, është mbajtur procesverbal administrativ nga sekretarja gjyqësore për të pasqyruar këtë fakt dhe për të njoftuar palët për seancën vijuese. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpatria apo kërkesa penale për gjykim, provat shkresore, aktet e ekspertimit (kur ka të tilla), kërkesat e palëve gjatë gjykimit (kur ato paraqiten me shkrim) , procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim dhe vendimet përfundimtare. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Lidhur me procesverbalin gjyqësor është konstatuar se shënohet saktësisht ora e fillimit dhe e përfundimit të seancës. Në 2 seanca, shkaku i vonesës nuk është dokumentuar në procesverbal (shih dosjet 4 dhe 5). Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar rregullisht aktet procedurale”.*

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e çdo seancë përgatitore apo gjyqësore, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (patria, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e "Aftësitë organizative të gjyqtares"

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se "Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etiken në punë të gjyqtares Rezarta Aliu. Gjatë periudhës së rivlerësimit, për të është paraqitur vetëm 1 ankesë në vitin 2014, e cila është verifikuar për zvarritje dhe në përfundim , i është regjistruar gjyqtares për vlerësim profesional dhe etik. Ndaj saj nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe nuk është dhënë ndonjë mase disiplinore (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore te KLD-së)".

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.1290/3 Port., datë 20.07.2018, rezulton se 1 (një) ankesë e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje të gjyqimit dhe është vendosur tërheqja e vëmendjes me shkrim dhe i është evidentuar për efekt vlerësimi etik dhe profesional. Në lidhje me këtë ankesë rezulton se:

Shtetasja E.R. ka bërë ankesë pranë KLD në vitin 2014 ndaj veprimtarisë së gjyqtares për zvarritje të gjyqimit në lidhje me çështjen civile me palë kërkuese shtetasin S.R., me objekt “Rivendosje në afat të ankimit”. Për verifikimin e ankesës është urdhëruar me urdhrin nr. 1349/2 Prot., datë 09.05.2014, kryerja e verifikimit brenda datës 16 qershor 2014.

Në datën 20.10.2014 inspektorët e KLD pasi kanë verifikuar ankesën dhe dokumentacionin përkatës kanë konkluduar se : *“Gjykimi i kësaj çështje nga data e shortit 27.01.2014 deri në datën e kontrollit 29.05.2014, ka zgjatur 4 muaj e 2 ditë. Janë zhvilluar gjithsej 5 seanca përgatitore. Të gjitha seancat janë të justifikuara me shkaqe shtyrje. Shtyrja e seanceve nga njëra tek tjetra janë minimumi nga 14 ditë, dhe maksimumi deri në 26 ditë, përjashtuar rasti i seancës nga data 24.02.2014 deri 24.03.2014 e cila shkon pak më gjatë, 28 ditë, dhe kjo ka ndodhur për shkak se duhej lëshuar dëshmia e trashëgimisë e të ndjerit Y.Z., që të bëhej zëvendësimi procedural. Nga këto që paraqiten pak më lart, rezulton se nga ana e gjyqtares janë bërë përpjekje reale për zhvillimin e gjyqimit, por ajo nuk ka mundur që ta përfundojë atë brenda afatit të caktuar nga K.L. Drejtësisë, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional. Në këtë rast, duhet patur parasysh edhe veprimi i domosdoshëm që ka patur kjo çështje, ku është kërkuar nga kërkuesi që të merrte dëshminë e trashëgimisë e të ndjerit Y.Z., si dhe më pas të bëhej zëvendësimi procedural, veprime këto që kanë marrë kohën nga ky gjykim. Si konkluzion, konstatohet se gjyqtarja [] ka tejkalluar afatin e parashikuar nga neni 5, germa “j” e vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, ku afati i parashikuar për këtë kategori çështjesh është 2 muaj. Është e qartë që gjyqtarja nuk e ka menaxhuar mirë këtë gjykim, dhe ka tejkalluar afatin 2 mujor të përcaktuar nga K.L.Drejtësisë, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional. Për këtë rast, vlerësohet e arsyeshme që kjo çështje t’i regjistrohet gjyqtares Rezarta Aliu, si çështje e zgjidhur tej afatit standard të përcaktuar nga K.L.Drejtësisë, duke u bërë pjesë*

përbërëse e dosjes së vlerësimit etik dhe profesional të asaj gjyqtares, dhe e përdorshme vetëm në rastin e vlerësimit etik dhe profesional”.

Lidhur me raportin e Inspektoratit të KLD, referuar vendimit të KPK, rezulton se : *“Lidhur me këtë çështje, në parashtrimet e saj, subjekti ka sqaruar se gjykimi është shtyrë pikërisht për shkak të mosmarrjes dijëni rregullisht të palëve, çka do të përbënte shkak për prishjen e vendimit nga një gjykatë më e lartë, duke qenë se personat e tretë nuk ishin banorë të Përmetit, por banorë të Pogradecit dhe Tiranës dhe, si të tilla, afatet e njoftimit të tyre nuk mund të ishin të shkurtra. Përveç kësaj ajo ka deklaruar se nuk është vënë në dijeni nga Inspektorati i KLD-së as për verifikimin dhe as për rezultatet e përfundimit të këtij verifikimi. Për të mbështetur pretendimet e saj subjekti ka paraqitur akte të dosjes me nr. 3, datë regjistrimi 5.2.2014, që i përket kërkuetit të njehsuara me origjinalin. Nga verifikimi i akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se shtyrja e seancave gjyqësore kanë qenë për shkak të mosmarrjes dijëni rregullisht të palëve, pra, për shkaqe të justifikuara dhe, për këtë arsye, tejkalimi i afateve në gjykim nuk mund të përbejë shkak që cenon aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit”.*

Referuar akteve të dosjes së rivlerësimit, si dhe dosjes personale të gjyqtares | nuk rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, të jetë dhënë apo zbatuar mase disiplinore ndaj saj.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që të dëshmojnë shfaqje e sjellje që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtares.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 372, datë 22.04.2021, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtares, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional, janë gjetur të pabazuara.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin "Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se "Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm".

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:*

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj gjyqtarës në periudhën e vlerësimit, të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit "8 tetor 2013 - 8 tetor 2016", për gjyqtaren I është paraqitur vetëm 1 (një) ankesë në Inspektoratin e ish KLD. Ankesa është paraqitur në vitin 2014 dhe është referuar dhe analizuar në treguesin e analizuar më sipër. Në materialet për verifikimin e ankesës rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se *“Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë u vërtetua se subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu: i) ka kryer deklarime të sakta në përputhje me ligjin (germa “a”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016); ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016); iii) subjekti nuk ka kryer fshehje pasurie (germa “c”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016); iv) subjekti nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (germa “d”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016). Për sa më sipër Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016”.*⁶²

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 372, datë 22.04.2021, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtares, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: *“Në përfundim, në lidhje me kontrollin e figurës, nga Komisioni nuk u evidentuan fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës pranë DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit, znj. është e përshtatshme për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/201”.*⁶³

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Faqe 42-43 e vendimit të KPK nr. 372, datë 22.04.2021.

Faqe 44 e vendimit të KPK nr. 372, datë 22.04.2021.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin "Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se "Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit ..Nga ana tjetër, ajo duke qenë pjesë e seksionit të përgjithshëm, ka shqyrtuar vijimisht çështje civile e penale, ku janë evidentuar çështje për të miturit apo kur i mituri është thirrur për të dëshmuar. Në këto raste, ajo ka treguar kujdesin e duhur, duke zbatuar parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si dhe ka proceduar me pyetjen e të miturit në prani të një psikologu (shih dokumentin 2, si dhe dosjet 3 dhe 5). Në një rast, ajo ka shqyrtuar një kërkesë për autorizim të tjetërsimit të pasurisë së të miturit dhe nuk ka proceduar me pyetjen e të miturit prej 13 vjeç, ndonëse duhet evidentuar se ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë (shih dosjen 1). Ndërsa në 1 rast tjetër, akuza penale lidhej me dhunën në familje, por në fund është disponuar pushimi i çështjes penale për shkak të amnistimit të veprës me ligj (shih dosjen 5). Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vëne në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit".

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës

diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarës.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin "Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se "...Për vetë gjyqtaren në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve....".

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarës, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës në

periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin "Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares" vlerësohet "I pakonsiderueshëm", duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale"

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja komunikon me etike me palët ndërgjyqëse, qofte në seancat përgatitore, qofte në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në një rast, është konstatuar se në gjykim ka patur debat të papërshtatshëm midis mbrojtëses dhe prokurorit, ku gjyqtarja ka reaguar me ndërprerjen e seancës (shih dosjen 5). Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normal komunikimi në përputhje me etiken gjyqësore dhe i qartë”*.

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin "Komunikimi i qartë dhe transparent" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale" vlerësohet "I lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se "Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me koleget dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekt i ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Gjyqtarja ka patur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, ku në 2 raste shkaku i tyre nuk është relatuar (shih dosjet 4 dhe 5), megjithatë parë në tërësi veprimtaria e saj, vlerësohet se kjo e dhënë lidhet me aftësitë organizative të saj. Nuk ka patur vonesa në arsyetimin e vendimeve, që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe koleget në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur".

Në aktin e vlerësimit të përshpejtuar për periudhën e vlerësimit janar-dhjetor 2014, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se "Sipas vetëvlerësimit të gjyqtares dhe vlerësimit të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, gjyqtarja ka respektuar me korrektësi normat e etikës gjyqësore me palët pjesëmarrëse e midis kolegësh, me administratën dhe me titullarin e gjykatës. Gjatë seancave gjyqësore, por edhe jashtë tyre, ka komunikuar dhe vepruar konform rregullave të etikës. Gjatë periudhës së vlerësimit nuk është evidentuar ndonjë mosmarrëveshje apo problem lidhur me marrëdhëniet profesionale me të tretët...".

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar; "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarës dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin "Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarës dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin "Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T'U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se "Gjyqtarja i nënshtrohet detyrimit programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjatë periudhës së rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 24 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shih të dhënat tek trajnimet në 3 Vitet e Fundit). Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 39 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarës së shkollës së parë, të paorganizuar në seksione. Gjatë periudhës së rivlerësimit nuk

dokumentohet që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale, jashtë Shkollës së Magjistraturës”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDEUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.1290/3 Prot., datë 20.07.2018, vërtetimit me nr. 427/1 Prot., datë 27.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ajo ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr.427/1 Prot., datë 27.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtarja është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në 24 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 39 ditë trajnimi.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 24 aktivitete të zhvilluara për 39 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

D

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.



Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lektore dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin "Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve", gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- "Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar" për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari. për gjyqtaren Rezarta Aliu ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin "Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata", gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 98/6, datë 14.10.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dosja personale e gjyqtarës;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të vetëvlerësimit profesionale të gjyqtarës, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtaren ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, nuk mund të vlerësohet për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	95	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	91	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	377	Shkëlqyeshëm



PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



SHTOJCA I
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN -----
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit
			95	Shkëlqyeshëm
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsycimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë




	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Mbi mesataren	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES					Pikët total	Niveli i vlerësimit
					91	Shkëlqyeshëm
	Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë	
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	11-20 %	4	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë	
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë	



					Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit. 	Mbi 87-93 %	6	Tej standardit : Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar. 	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtares: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së 	Mbi mesataren	16	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë





		vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).			Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	Pikët total	Niveli i vlerësimit
	100	Shkëlqyeshëm

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarës: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarës	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarës : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarës	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë

Handwritten signatures and marks at the bottom of the page.

1915
MAY 12
1915

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	▪ Dosja e rivlerësimit.	I pa konsiderueshëm	15	Shumë e lartë- 10 pikë Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë

C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit.	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtares: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			377		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES			Shkëlqyeshëm		



